

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

E ENJTE 5 TETOR 2023

Faleminderit, drejtuese e seancës!

Në fakt, Shqipëria gjatë procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian merr fonde nga Bashkimi Europian, me qëllim që t'u afrohet standardeve të vendeve të Bashkimit Europian. Jo më larg se dje delegacioni i Bashkimit Europian i bëri thirrje këtij Kuvendi që të trajtojë si prioritet të prioriteteve reformën zgjedhore, adresimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, ku qartësisht evidentohet përdorimi i administratës publike, si një bandë kriminale kundër opozitës në zgjedhjet vendore, njëlloj si edhe në zgjedhjet e para dy vjetëve, pra në të njëjtin standard, evidentoheshin shqetësimet e ekspertëve të OSBE-ODIHR-it për shitblerje të votave, evidentohet përdorimi i krimit të organizuar në zgjedhje, si dhe keqpërdorimi i burimeve shtetërore në zgjedhje. Të gjitha këto çështje, në fakt, janë përsëritje e raportit të OSBE- ODIHR-it, referuar edhe zgjedhjeve të vitit 2021. Do të ishte në nderin e këtij Kuvendit që secili prej kolegëve deputetë në dy vjet, pra nga shtatori i vitit 2021, ku bashkërisht ngritëm Komisionin e Reformës Zgjedhore, deri në zgjedhjet e muajit maj 2023, t'i kishim reflektuar të gjitha shqetësimet e OSBE-ODIHR-it. Fakti që OSBE-ODIHR-i ju rrezoi edhe zgjedhjet e 14 majit, në fakt, reflektohet edhe nga një e dhënë shumë e thjeshtë: askush nga qeveria apo mazhoranca as e mirëpriti dhe as e përshëndeti raportin e OSBE-ODIHR-it, sepse për ju ekspertët e OSBE-ODIHR-it dhe rekomandimet e tyre nuk kanë asnjë vlerë. Për ju ka vlerë vetëm përsëritja dhe përmirësimi i metodave kriminale, zgjedhje pas zgjedhjesh, me qëllim që të vidhni zgjedhjet dhe, përmes vjedhjes së zgjedhjeve, më pas të vidhni Shqipërinë. Prej tri javësh kemi dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë një kërkesë tërësisht normale ligjore të opozitës, që të bëjmë funksional Komisionin e Reformës Zgjedhore.

Nuk kemi kërkuar asnjë favor nga mazhoranca, por kemi kërkuar një të drejtë që na e njej Kushtetuta, na e njej Rregullorja e Parlamentit dhe, sigurisht, e njej tradita e këtij Parlamenti në 32 vjet. Por çfarë bëni ju?! Pasi e vononi për 3 javë një kërkesë normale të opozitës, sepse interesi juaj është ta mbani të bllokuar reformën zgjedhore, bëni teatër në mëngjes sikur jeni në konflikt me një koleg tonin, që ka vendosur të keqpërdoret në këtë histori, i cili po zihet me Kryetaren e Kuvendit, dhe vini në darkë e na thoni (siç, në fakt, e keni marrë vendimin) që përfaqësuesit e opozitës në Komisionin e Reformës Zgjedhore nuk do t'i caktojmë ne, të nderuar kolegë, por do të na i caktojë ky krahu këtej. Nuk i mjaftojnë 9 anëtarët e vet në Komisionin e Reformës Zgjedhore, por duan të paracaktojnë edhe 9 anëtarët, që do të përfaqësojnë opozitën, sepse qëllimi i vetëm ka qenë dhe mbetet ta shtyjnë reformën zgjedhore deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, të mos marrin asnjë masë për të frenuar keqpërdorimin e administratës publike, keqpërdorimin e burimeve shtetërore, përdorimin e krimit të organizuar në zgjedhje, shitblerjen e votës me paratë e krimit të organizuar në zgjedhje dhe të vijnë këtu e të krekosen se fitojnë zgjedhjet. Të nderuar kolegë, Ne kemi shpallur si prioritet realizimin e reformës zgjedhore dhe përshëndesim deklaratën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të delegacionit të Bashkimit Europian që na kërkonte ta trajtonim si prioritet. Ju na thatë në nisje të këtij sesi se e kishit prioritet reformën zgjedhore, por çfarë keni bërë?! Keni dy javë që i keni zgatur afatin Komisionit të Reformës Zgjedhore dhe vijoni të silleni sikur Komisioni i Reformës Zgjedhore nuk ekziston, sikur çështja e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme nuk është një çështje që përbën shqetësim dhe prioritet për qytetarët e Republikës së Shqipërisë. Si ka mundësi që pretendoni të jeni një vend demokratik, ndërkohë kërkonti t'i impononi opozitës se cilët do të jenë përfaqësuesit e opozitës në Komisionin e Reformës Zgjedhore? Pse?! Sepse e keni shumë të lehtë, Damiani nuk ka interes të bëhet reforma zgjedhore, është e qartë, sepse është përfaqësuesi i kësaj mazhorance, që i

ka bërë këto të zeza, të paktën në dy palë zgjedhje, dhe do që kjo çështje të lihet në harresë, siç, për fat të keq, është lënë në harresë për 1 vit e gjysmë edhe nga opozita, ndërkohë që duhet të ishte prioriteti i prioriteteve tona, i shpallur që në shtator të 2021-shit. Vini këtu e bëni teatër sikur keni interes t'i zgjatni afatin Komisionit të Reformës Zgjedhore, t'i jepni jetë atij dhe ta realizoni reformën zgjedhore, kur, në fakt, doni të bëni fiks atë që bëtë në vitin 2020, tre apo katër muaj përpara zgjedhjeve... (Ndërhyrje pa mikrofon) A ka mundësi ajo kopeja atje në fund të ulet në vend dhe të kemi mundësi të flasim si njerëz?! (Ndërhyrje pa mikrofon) Janë mbledhur atje, ne flasim këtu, ata bëjnë muhabet atje. (Ndërhyrje pa mikrofon) Ndjesë për fjalën, sepse nuk kisha ndër mend të fyeja asnjë prej kolegëve, por t'i kthehem seriozitetit të Kuvendit. E kuptoj që s'e keni me shumë seriozitet as Kuvendin, as punën e Kuvendit dhe as funksionimin demokratik të Kuvendit. Unë ndiej keqardhje për kolegun tim, zotin Çuçi, i cili 3 herë, publikisht, po t'i hapni procesverbalet e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, u zotua që kërkesa e opozitës për ndryshimin e përbërjes pa diskutim që do të merret në konsideratë, si dhe që nuk mund t'i caktojmë ne përfaqësuesit tuaj, ndërsa sot sollën dikë të bënte teatër, sikur po zihej me Lindita Nikollën, sepse, në fakt, e kishit marrë këtë vendimin dhe mendoni se teatrin tuaj të skutave dhe qosheve të Tiranës do t'ua hidhni si hi syve shqiptarëve. Të nderuar kolegë, Keni vetëm një rrugë për ta çuar përpara reformën zgjedhore: të bëni funksional Komisionin e Reformës Zgjedhore, të respektoni të drejtën e opozitës për t'i caktuar ajo përfaqësuesit e saj në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe, bashkërisht, të përmbushim rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, të paktën të dy palë zgjedhjeve, edhe për zgjedhjet e vitit 2021, edhe për zgjedhjet e vitit 2023, dhe të kemi mundësi që, të paktën, ato fenomene negative që mund të rregullohen me ligj, sepse jo të gjitha rregullohen me ligj, t'i adresojmë kohë përpara, siç standardet europiane e kërkojnë, përpara zgjedhjeve të ardhshme elektorale.

Meqenëse ju e keni marrë vendimin tuaj, ne presim vetëm të na komunikoni kë doni ju të caktojmë ne, si opozitë, në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe meqenëse nuk ju pëlqejnë emrat tanë, na jepni një listë kë të doni ju, me 9 anëtarët tanë, dhe na e sillni si propozim, në mënyrë që ne t'ju sjellim formalisht emrat që doni ju! Uluni tani dhe bëni një listë kë doni ju që të caktojmë ne në Komisionin e Reformës Zgjedhore, ose, po të doni, ndryshojmë vendimin që miratuam herën e kaluar dhe thoni: "Reformën zgjedhore e bën një komision i përbërë nga 18 anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste"! E keni këtë mundësi, votat i keni, shumicën e keni, bëjeni këtë! Meqenëse e keni marrë vendimin si grup parlamentar, zonja drejtuese e seancës, në përputhje me nenin 52 të Rregullores së Kuvendit, unë kërkoj 15 minuta pushim për mbledhje të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Rregullorja thotë: "Drejtuesi i seancës (ti, zonja ish-prokurore), me kërkesë të një grupi parlamentar mund ta ndërpresë seancën plenare për jo më shumë se 60 minuta, vetëm një herë, për të njëjtën çështje". Në cilësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kërkoj edhe një herë 15 minuta pushim. Kam nevojë për mbledhje të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Është një kërkesë në përputhje me Rregullores, e zbatuar disa herë nga grupi juaj. Ju keni marrë vendimet për ne, ne do të duhet të marrim vendimet për veten. Prandaj, të kërkoj të zbatosh Rregulloren dhe të japësh 15 minuta pushim, siç Rregullorja na e kërkon për të zhvilluar mbledhje të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Zoti Çuçi ta marrë më pas fjalën, sepse ndërpritet seanca. Seanca ndërpritet atëherë kur paraqitet kërkesa, Rregullorja nuk thotë: "E shtyjmë sa të mbarojnë të gjitha diskutimet dhe pastaj e ndërpresim", sepse nuk quhet ndërprerje. Kur mbarojnë të gjitha diskutimet, mbaron seanca. Ne kërkojmë ndërprerje...